Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-21/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-21/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.09.2026, duke vepruar sipas kërkesës së Ministrisë së financave Nr. 02/13271/2026 të dt. 31.07.2026 për kthim në rivendosje të vendimit te kuvendit të komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0050850-8/26 dt. 31.08.2026); sjell këtë:

VENDIM
Për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 për zhvlerësimin dhe dhënien donacion të 35 laptopëve që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025

1. MIRATOHET Vendimi Për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 për zhvlerësimin dhe dhënien donacion të 35 laptopëve që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi FSHIHET pika 1 (një) e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026, dhe i njëjti ZËVENDËSOHET me tekstin si në vijim:
   1. Kuvendi i Komunës e AUTORIZON Kryetarin e Komunës që duke u bazuar në vlerësimet, rekomandimet e pranuara nga Komisioni për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare, duke pasur parasysh se Arsyeshmëria e tjetërsimit të pasurisë duhet të bazohet në faktin që pasuria është e pa përdorshme dhe jashtë funksionit të organizatës buxhetore, duke pasur parasysh që Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore duke iu nënshtruar normave të zhvlerësimit marrë parasysh faktin së sipas nenit 22, paragrafi 4, nënparagrafi 4.8, të Rregullores së lartcekur norma e përgjithshme e zhvlerësimit për Pajisjet e teknologjisë informative është 3 vite; dhe duke u bazuar ne nenin 9, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, laptopët (NB LENOVO V 14-IIL 15-1035G1 14") që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025 (gjithsejtë 35 laptopë) t'ua jap në formë të dhuratës apo transferit anëtarëve të Kuvendit të mandatit 2021-2025.
3. Pikat tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Sadet KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 **Kryesuesit të Kuvendit**
1 x 1 **MAPL-së**
1 x 1 **Arkivit**
Kopje: **Kryetarit të Komunës**